

Në bazë të nenit 149 paragrafi 149 të Ligjit për arsimin e lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 82/2018) dhe në përputhje me nenin 48 të Statusit të Institucionit privat gjerman të arsimit të lartë - Shkolla e lartë profesionale FAKULTETI HAJDELBERG NË SHKUP (në tekstin e mëtejshëm: FAKULTETI HAJDELBERG NË SHKUP) Këshilli arsimor shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE TË SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE FAKULTETI HAJDELBERG NË SHKUP NË VITIN AKADEMIK 2025/2026

Në Shkollën e lartë profesionale FAKULTETI HAJDELBERG NË SHKUP mund të regjistrohen gjithsej 60 studentë në vitin e parë të ciklit të parë të studimeve profesionale në vitin akademik 2025/2026, prej të cilëve:

- 30 studentë në programin studimor për Administrim biznesi - banka, sigurim dhe kontrolling; dhe
- 30 studentë në programin studimor për Të dhënat dhe shkencat kompjuterike.

Këshilli arsimor në seancën për përcaktimin e numrit të studentëve për regjistrim në vitin e parë në vitin akademik 2025/2026 e propozon këtë numër të studentëve:

Programi studimor	Gjuha në të cilën mbahen ligjëratat	Vende të lira	Studentë të rregullt	Studentë me korrespondencë	Kohëzgjatja e studimeve
Administrim biznesi - banka, sigurim dhe kontrolling	Gjuha angleze	30	10	20	6 semestra, prej të cilëve një në Gjermani
Të dhënat dhe shkencat kompjuterike	Gjuha angleze	30	10	20	6 semestra, prej të cilëve një në Gjermani
Gjithsej		60	20	40	

Tarifa për regjistrim dhe ndjekje të mësimin në ciklin e parë të studimeve profesionale në programet studimore – diplomë e dyfishitë me R.F. Gjermania, për një vit akademik me vlerë prej 60 ECTS, është 1.100 euro në kundërvlerë në denarë ndaj FAKULTETIT HAJDELBERG NË SHKUP dhe shpenzime ndaj Universitetit në Frankfurt – Provadis, R.F. Gjermania në shumë prej 2.800 eurosh në kundërvlerë me denarë. Tarifa për regjistrim dhe ndjekje të mësimin në ciklin e parë të studimeve profesionale në programet studimore, si dhe kushtet për mënyrat e mundshme të pagesës dhe zbritjet që miratohen, rregullohen me Rregulloren për tarifat financiare për ciklin e parë të studimeve profesionale të FAKULTETIT HAJDELBERG NË SHKUP dhe Universitetit në Frankfurt – Provadis, R.F. Gjermania.

Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve profesionale në FAKULTETIN HAJDELBERG NË SHKUP kanë kandidatët që kanë kaluar maturën shtetërore ose maturën ndërkombëtare.

Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve profesionale kanë edhe kandidatët me arsim të mesëm katërvjeçar të përfunduar sipas rregulloreve që kanë qenë në fuqi para vendosjes së maturës shtetërore (para vitit shkollor 2007/2008), të cilët nuk kanë dhënë maturën shtetërore, si dhe kandidatët që e kanë përfunduar arsimin e mesëm katërvjeçar në vitin shkollor 2019/2020, në përputhje me Dekretin me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsimin e mesëm gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Shtetasit e huaj regjistrohen në studime me të njëjtat kushte ligjore si shtetasit vendas dhe, të cilët së bashku me aplikimin, dorëzojnë vendimin për nostrifikim të arsimit të mesëm të përfunduar përkatësisht dëshmi se kanë filluar procedurën e nostrifikimit pranë institucioneve kompetente.

Nëse në konkurs paraqiten më shumë kandidatë se numri i përcaktuar sipas këtij konkursi, përzgjedhja e tyre do të bëhet nëpërmjet renditjes sipas një testimi dhe interviste që do të realizohen nga një komision i përbërë nga profesorë gjermanë të FAKULTETIT HAJDELBERG NË SHKUP.

FAKULTETI HAJDELBERG NË SHKUP për kandidatët që do të regjistrohen në ciklin e parë të studimeve do të organizojë:

- - mësim përgatitor me mentorë të njohur, profesorë nga Gjermania dhe sipërmarrës me përvojë;
- - këshillim për karrierë dhe trajnime motivuese nëpërmjet Shkollës për menaxhimin e talentëve që funksionon në kuadër të FAKULTETIT HAJDELBERG NË SHKUP, me ligjërata nga folës motivues dhe trajnerë për zhvillim personal; dhe
- - trajnim për përgatitjen e një biografie, letre motivuese dhe interviste pune.

VËREJTJE: Afati i regjistrimit fillon me shpalljen e konkursit dhe do të vazhdojë deri më 01.10.2025

Dokumentet për paraqitje dhe regjistrim

1. Fletëparaqitje për regjistrim
2. Dëftesa origjinale nga viti I - IV
3. Dëftesë për arsim të mesëm të përfunduar
4. Dokument për kalimin e maturës shtetërore
5. Certifikatë nga libri amë i të lindurve
6. Dëshmi për shtetësi (vërtetim ose vendim)
7. Dy fotografi (madhësia 2 x 3 cm)

Ligjëratat do të mbahen në hapësirat e FAKULTETIT HAJDELBERG NË SHKUP, me seli në rr. Kosta Novakoviq nr. 16, Aerodrom, 1000 Shkup dhe R. F. Gjermani (Hajdelberg dhe/ose Frankfurt).

Informacione më të detajuara në lidhje me këtë konkurs mund të merren në hapësirat e FAKULTETIT HAJDELBERG NË SHKUP, si dhe në numrin e telefonit 070 355 656, në postën elektronike info@heidelberg.edu.mk ose në FAKULTETI HAJDELBERG NË SHKUP: www.heidelberg.edu.mk

FAKULTETI HAJDELBERG NË SHKUP
Këshilli arsimor